



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P nr. 17/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, sipas Kryetares se trupit gjykues – Lumturije Muhaxheri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Shpresa Kërnya, në lëndën penale të akuzuarve, B.P nga ..., për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK, e të ricilësuar në shqyrtim fillestar në veprë penale: përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK, si dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK dhe i akuzuari D.M, nga ..., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK, të dy këto të fundit të ricilësuar në shqyrtim fillestar në veprë penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PP/I nr.360/15 dt.27.01.2016, në seancën e shqyrtimit fillestar publik, të mbajtur me dt.18.05.2016, në praninë e Prokurorit të Shtetit – Agim Kurmehaj, të akuzuarit Besart Pepaj, mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare, avokati R.R dhe i akuzuari D.M, të njëjtën ditë mur dhe publikisht shpalli, dhe me dt. 09.06.2016 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit :

1.B.P, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr.personal ..., i lindur me ..., në ..., me banim në ..., i biri i ... dhe nënës ..., e gjinisë ..., ka të kryer ..., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës,

2.D.M, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr.personal ..., i lindur me ..., në ..., ku edhe tani jeton në rr. ...'', i biri i ... dhe nënës ..., e gjinisë ..., ka të kryer ..., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

I akuzuari B.P

Për shkak se

1.Me dt. ... rreth orës ... në parking të ... i njëjti ka përdorur armën në mënyrë kërcënuese dhe atë një pistoletë RECK MOD me numër serik 623621717 PP.cal 9mm p.a.k dhe një karikator, në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri pas një grindje që kishte pasur me tani të dëmtuarin B.P me qëllim frikësimi ka shtënë dy herë me të njëjtën armë në drejtim të qiellit e cila armë më vonë është sekuestruar nga policia së bashku me një karikator të zbrazët,

- me çka ka kryer veprë penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPK.

2.Me dt.... rreth orës ... në parking të ... tjetrit i shkakton lëndime të lehta trupore në atë mënyrë që i pandehuri kishte filluar një fjalosje me A.B dhe i dëmtuari B.P duke ndërhyrë në këtë konflikt që ti qetësoj goditet nga i pandehuri B me grushta dhe shqelma në pjesë të ndryshme të trupit duke i shkaktuar lëndime të lehta trupe.

- me çka ka kryer veprë penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.1 të KPK-së.

I akuzuari D.M,

Për shkak se:

Me dt.... rreth orës ... në parkingun e ... tjetrit i shkakton lëndim të lehtë trupor në atë mënyrë që duke ndërhyrë në një konflikt që kishte shoku i tij i pandehuri B.P me të dëmtuarin A. B, fillon të grushtoj dhe shqelmoj në pjesë të ndryshme të trupit duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore në bërryl të majtë dhe në këmbën e djathtë mbi gju,

- me çka ka kryer veprë penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.1 të KPK-së,

Të akuzuarit B.P,

Gjykata komfor nenit 80 të KPPRK,

Për veprën penale nën piken 1 të dispozitivit të këtij aktgjykimi i'a përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, të cilin dënim fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj nuk kryen veprë të re penale dhe dënim me gjobë në shumë prej 300 € (treqind) euro.

Për veprën penale nën piken 2 të dipozitivit të këtij aktgjykimi i'a përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, të cilin dënim fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj nuk kryen veprë të re penale.

Gjykata me aplikimin e neneve 4, 7, 17 par.1, 21 par.2, 41, 49, 51, 62 par.2 pika 2.7, 69, 73, 75 par.1 pika 1.3, 80, 375 par.2, 188 par.1 pika 1.1 të KPRK, , si dhe në pajtim me nenet 365, 366,453, të KPPRK-së, te akuzuarve ju shqipton ,

DËNIM ME KUSHT

1.Te akuzuarin B.P,

Me dënim unik me burg ne kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 3 (tre) muaj, të cilin dënim fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj nuk kryen vepër të re penale dhe

Dënim me gjobë në shumë prej 300 € (treqind) euro, të cilën shumë është i detyruar ta paguaj në afat prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e në rast të mospagimit të dënimit me gjobë, do të zëvendësohet me dënim me burgim, në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, ashtu që çdo 20 € (njëzetë) euro, të dënimit me gjobë, i përcakton 1 (një) ditë burg.

Ndaj te akuzuarit B.P, shqiptohet dënimi plotësues, konfiskimi i armës te përshtuar sikurse nen piken I te dispozitivit te aktgjykimit, dhe urdhërohet, shkatërrimi i saj pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit, numri i rastit i evidentuar ne polici 2015-DC-559 te dt.15.12.2015.

2. Te akuzuarin D.M,

Me dënim burgu ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, të cilin dënim fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër të re penale.

Të akuzuarit D.M dhe B.P secili veç e veç, obligohet që në emër të paushallit gjyqësor, Gjykatës ti paguajnë shumën prej 50 € (pesëdhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Të dëmtuarit A.B dhe B.P, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Pejë - Departamenti për Krime të Rënda , ka ngrit aktakuzë, PP/I nr.360/15 dt.27.01.2016, kundër te akuzuarve B.P, nga ..., për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK, si dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK, i akuzuari D.M, nga ..., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit te Shtetit PP/I nr.360/15 dt.27.01.2016, i njëjti bën përmirësimin e aktakuzës ashtu që dispozitivi i parë që i referohet B.P, mbetet në tërësi i njëjtë vetëm se është bërë një lëshim teknik se te kjo vepër e përdorimit të armës duhet të figurojë neni 375 par.2 të KPRK-së.

Sa i përket dispozitivit të dytë i cili sërish i referohet të pandehurit B.P, kualifikimi i veprës penale për shkak të një lëshimi teknik duhet të jetë vepra penale nga neni 188 par.1 pika 1.1 të KPRK dhe dispozitivi nën pikën II duhet të jetë sinë vijim : Me dt..., rreth orës ..., në parkingun e ..., tjetrit i shkakton lëndim të lehtë trupor, në atë mënyrë që i pandehuri kishte filluar një fjalosje me A.B dhe i dëmtuari B.P, duke ndërhy në këtë konflikt që ti qetësojë goditjet nga i pandehuri Besart me grushta dhe shqelma në pjesë të ndryshme të trupit duke i shkakuar lëndime të lehta trupore.

Sa i përket dispozitivit të tretë të aktakuzës i cili i referohet të pandehurit D.M, kualifikimi i veprës penale për shkak të një lëshimi teknik duhet të jetë vepra penale nga neni 188 par.1 pika 1.1 të KPRK dhe dispozitivi nën pikën II duhet të jetë sinë vijim: Me dt. ..., rreth orës ..., në

parkingun e ..., tjetrit i shkakton lëndim të lehtë trupor, në atë mënyrë që duke ndërhyrë në një konflikt që kishte shoku i tij, i pandehuri B.P me të dëmtuarin A.B, fillon ta grushtojë dhe shqelmoj në pjesë të ndryshme të trupit duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore në bërryl të majtë dhe në këmbën e djathtë mbi gju.

Pas modifikimit të aktakuzës nga ana e prokurorit, në seancën e shqyrtimit fillestar, Gjykata është bindur së të akuzuarit e kanë kuptuar aktakuzën dhe duke vepruar në kuptim të nenit 246 par.4 të KPPRK-se , të akuzuarve iu ka dhënë mundësinë që të deklarohen për pranimin ose mospranimin e fajësisë. Me këtë rast, Gjykata i ka udhëzuar të akuzuarit për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë në kuptim të nenit 248 par.1 pika 1.1, 1.2, 1.3 të KPPK-se, kështu që të akuzuarit secili veç e veç kanë deklaruar së janë plotësisht të vetëdijshëm për rëndësinë e pranimit të fajësisë duke shtuar se ky deklarim paraqet shprehje të vullnetit të tyre të lirë, pasi të njëjtit janë kryes të veprave penale dhe nuk kanë si ta mohojnë , në tërësi e pranojn fajësinë për veprat penale për të cilat janë akuzuar sipas aktakuzës dhe se pranimi i tyre është i mbështetur edhe në provat të cilat i janë ofruar gjykatës me aktakuzë, të njëjtëve u vjen keq për rastin dhe se janë penduar duke i premtuar gjykatës që në te ardhmen nuk do ti përsërisin veprimet e tyre .

Pas deklarimit të akuzuarve për pranimin e fajësisë, Gjykata kërkoi nga Prokurori i shtetit dhe mbrojtësi i të akuzuarit B.P që të japin mendimin e tyre për pranimin e fajësisë.

Prokurori i Shtetit, në këtë drejtim deklaroi , me qenë se të akuzuarit secili veç e veç e pranuan fajësinë në bazë vullnetare, ndërsa i akuzuari i parë edhe pas konsultimit me mbrojtësin e tij, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e tyre, kërkon nga Gjykata që një pranim të tillë ta aprovoj, me qenë se një pranimi i tillë i fajësisë ka mbështetje edhe në provat në bazë të cilave është ngritur aktakuza.

Mbrojtësi i akuzuarit B.P, avokati R.R, në këtë drejtim dekoroj: se të akuzuarit e posaçërisht i mbrojturi i tij B, duke i kuptuar pasojat e aktakuzës, e cila e ngarkon dha pranimin e fajësisë në mënyrë vullnetare duke mos qenë i ndikuar, duke i vlerësuar këto rrethana i propozon gjykatës që të njëjtin ta pranon si të bazuar.

I dëmtuari A.B deklaroi se pajtohet me fjalën e të pandehurit, deri te pajtesa nuk ka ardhë, prej ditës kritike probleme më nuk kanë pasur dhe parashtron kërkesë për kompensim dëmi të cilin do ta realizoj në kontest civil.

Meqenëse i dëmtuari B.P nuk ka qenë prezent, gjykata e ka lexuar deponimin e tij të dhënë në prokurori me dt.11.01.2016 ku ndër të tjera ka theksuar se ‘ B e ka dërgu një dajë të vetin dhe baba i D.M kanë kërkuar falje për veprimet e tyre, aty ka qenë prezent edhe prindi im i cili tha se këtë çështje do të ja lë gjykatës në vlerësim’ ndërsa lidhur me kompensimin nuk ka deklaruar asgjë.

Në vijim, Gjykata duke e shqyrtuar pranimin e fajësisë, nga ana e të akuzuarve vlerësoi së pranimi i fajësisë paraqet shprehje të vullnetit të lirë të tyre, pasi që ata secili veç e veç e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe pranimi i fajit është bërë në mbështetje të fakteve të prezantuara në aktakuzë, në përputhje me kërkesat e nenit 248 par.1 pika 1.1, 1.2, 1.3 të KPPR të Kosovës.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit.

Nga gjendja e vërtetuar faktike, siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të akuzuarit B.P, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 KPRK-së dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.1 të KPRK, kurse në veprimet e të akuzuarit D.M, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.1 të KPRK.

Sa i përket fajësisë, Gjykata ka gjetur se tek të akuzuarit ka ekzistuar dashja që veprat penale ti kryejnë në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që të njëjtit kanë qenë të vetëdijshëm për veprat e kryera dhe e kanë dëshiruar kryerjen e tyre .

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarve , kështu që të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Duke pas parasysh se Gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve ne shqyrtimin fillestar dhe, ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par.1 pika 1.1, 1.2, 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushtet nga neni 248 par 4 të KPPRK-së, në këtë çështje penale nuk është zbatuar seanca e dytë e shqyrtimit gjyqësor e as shqyrtimi gjyqësor, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, njëherit bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Prishtinë dhe, Gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të EULEX-it, me nr.GjA.nr.207/13 dt.19.03.2013, me rastin e shpalljes se te akuzuarve fajtor dhe shqiptimin e dënimit nuk është plotësuar fare trupi gjykues.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjykata i ka vlerësuar te gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim te nenit 73 par.1 te KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për te akuzuarit gjykata pati parasysh padënueshmerinë e tyre të më parshme, Gjykata ka vlerësuar sjelljen e tyre korrekte gjate shqyrtimit fillestar, janë penduar për veprat e kryera , duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen një gjë e tillë më nuk do të përsëritet, gjendjen e vështirë ekonomike, kërkim faljen publike ndaj të dëmtuarve të cilat gjithashtu kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana favorizuese. Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin D, kurse për të akuzuarin B si rrethanë veçanërisht lehtësuese, gjykata e merr faktin se të njëjtit qysh ne fillim te hetimeve e edhe në seancën e shqyrtimit fillestar e kanë pranuar fajësinë për veprat penale qe i ngarkon aktakuza, gjë që dëshmuar gatishmëri për bashkëpunim me organin e akuzës dhe me gjykatën dhe kjo sipas vlerësimit të gjykatës paraqet pendim të sinqertë të tyre dhe fillim të procesit të rehabilitimit të tyre, ne prezencën e këtyre rrethanave lehtësuese dhe në mungesë të ndonjë rrethane rënduese të akuzuarin B.P konform nenit 75 par.1 pika 1.3 të KPRK-së dhe të akuzuarin D.M i ka gjykuar për veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi me te cilën do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Duke i vlerësuar kështu te gjitha rrethanat e parashikuar me nenin 73 par.1 te KPRK-se, Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar te akuzuarve është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale te tyre dhe me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura te shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do te shërbej për arritjen e qëllimit te dënimit në pengimin e të akuzuarve në kryerjen e veprave penale në të ardhmen por ai do të ndikoj edhe si preventivë generale për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 41 te KPRK-se .

Vendimin mbi dënimin plotësues ndaj të pandehurit B.P marrjen e armës, dhe atë një pistoletë të tipit RECK MOD me numër serik 623621717 PP, cal 9 mm, p.a.k dhe një karikator, u murr komfor nenit 62 lidhur me nenin 69 te KPRK-së.

Duke u bazuar ne nenin 450 par 2 pika 2.6 te KPPRK-se, Gjykata ka vendosur qe te akuzuarit ti obligoj në pagimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësorë.

Duke u bazuar ne nenin 463 te KPPRK-se, Gjykata të dëmtuarit A.B dhe B.P, për realizimin e kërkesës pasurore juridike i udhëzoi në kontest të rregullt civil.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 365 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar ne nenin 368 par.2 te KPPK-se, Gjykata palët ne procedure i njoftoi me paralajmërimet qe shoqërojnë aktgjykimin.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA,
P.nr. 17/16 të dt. 18.05.2016, përpiluar me dt.09.06.2016.**

**Sekretarja Juridike
Shpresa Kërnya**

**Kryetarja e Trupit Gjykes
Lumturije Muhaxheri**

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa ne afat prej 15 detesh, nga dita e marrjes, Gjykatës se Apelit ne Prishtine, e përmes kësaj Gjykate.